


TIRANË 2024

RREGULLORE PËR FITIMIN E
TITUJVE AKADEMIKË
NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS



UNIVERSITETI
POLITEKNIK
I TIRANËS

Sheshi "Nënë Tereza", 4
Tiranë ALBANIA
Tel: +355 4 2227914
Web: [upt.al](#)

MIRATOHET

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Akli Fundo



RREGULLORE PËR
FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË
NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i rregullores

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara, si dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asocuar" dhe "Profesor" në Universitetin Politeknik të Tiranës, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe rregullat që zbatohen nga subjektet pjesëmarrëse në procesin për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asocuar" dhe "Profesor", të drejtat e detyrimet e personelit akademik dhe organeve përgjegjëse për promovimin akademik, si dhe raportet me organet dhe autoritetet përgjegjëse për promovimin akademik.

Neni 2

Baza ligjore

- Rregullorja për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asocuar" dhe "Profesor" në UPT bazohet në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve për Fitimin e gradës shkencore "doktor" dhe të standardeve Shtetërore për fitimin e titujve Akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor""; i ndryshuar; VKM Nr. 128, datë 6.3.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asocuar" dhe "Profesor""; të ndryshuar", Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Kodin e Etikës së Universitetit Politeknik të Tiranës.

Neni 3

Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik

Organi përgjegjës për dhënien e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" në Universitetin Politeknik të Tiranës, është Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA).

Neni 4

Kriteret e përgjithshme për fitimin e titujve akademikë

1. Për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar" mund të aplikojë personeli akademik i kategorisë "Lektor", i cili ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor" të paktën 5 (pesë) vjet nga data e aplikimit për fitimin e titullit të mësipërm.
2. Për fitimin e titullit akademik "Profesor" mund të aplikojë personeli akademik i cili ka titullin akademik "Profesor i asociuar". Personeli akademik, i cili mban titullin akademik "Profesor i asociuar" aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor" të paktën 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asociuar".

Neni 5

Kritere vlerësuese akademiko-didaktike për fitimin e titujve akademikë

1. Personeli akademik, që aplikon për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", përvèç përbushjes së detyrueshme të kritereve të përgjithshme dhe standardeve shtetërore, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në këtë rregullore, do të vlerësohet edhe për kriteret e mëposhtme:
 - a) kontributi institucional, ku përfshihen veprimtaritë akademike dhe administrative në mbështetje të njësive bazë, njësive kryesore, institucionit dhe administratës publike;
 - b) paraqitja e dorëshkrimeve shkencore të pabotuara më parë;
 - c) pjesëmarja në borde revistash shkencore apo serial botimesh shkencore (joperiodike) apo veprimtari të tjera formuese të ciklit të tretë të studimit.
 - ç) hartim projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - d) aftësi drejtuese akademike dhe kryerja e detyrave menaxheriale brenda universitetit dhe jashtë tij;
 - e) çmime kombëtare dhe ndërkombëtare shkencore të fituara nga personeli akademik në vendet e BE-së, OECD-së dhe G-20-ës.

KREU II

STANDARDET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK "PROFESOR I ASOCIUAR"

Neni 6 Përvoja akademike

1. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet:
 - a) të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për së paku një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;
 - b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5 (pesë)-vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje.
- Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se pesë vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme ~~më të ulët se 8 (tetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përllogaritet me një koeficient prej 1.6 vite kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor".~~.
- c) të jetë i aftë të mbajë ligjérata në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, fränge, gjermane, italiane, spanjolle para jurisë në përputhje me statutin, rregulloren e IAL-së dhe nenin 20 të kësaj rregulloreje.

Neni 7 Botimet e realizuara nga personeli akademik

1. Personeli akademik, që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:
 - a) Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal

Citation Indicator (JCI).". Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2(dy) artikuj shkencore të paraqitur për fitimin e titullit.

- b) ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkontinentale (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 8

Monografia shkencore

1. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të Nenit 6, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - a) botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulan fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përbajtje me të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) "Profesorë" të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës, për të cilin duhet të paraqitet evidencë e titullit "Profesor" në vendin përkatës.
 - b) Të gjitha procedurat e pikës a, të kryhen/të jenë kryer para procesit të botimit.
 - c) monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkontinentale, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njoitura ndërkontinentale, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).".

- d) monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

 - i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii) 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njoitura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).".

e) Monografia do t'i njihet, për efekt ekuivalentimi sipas përcaktimeve, përkatësisht, të paragrafit b), Pika 6 të Kreut II të VKM. 112, datë 23.02.2018, të ndryshuar, vetëm dy autorëve sipas rasteve te meposhtme:

 - Në rastin kur monografia ka vetëm dy autorë, do t'i njihet të dy autorëve.
 - Në rastin kur monografia ka më tepër se dy autorë, do ti njihet dy autorëve që kanë përqindjen më të madhe të kontributit kur kjo perqindje eshte e pasqyruar në vendimin e njësisë bazë dhe/ose nga vetë autorët në hyrjen e monografisë së botuar.
 - Në rastin kur monografia ka më tepër se dy autorë, do ti njihet vetëm autorit të parë dhe të dytë sipas renditjes në monografi, kur përqindja e kontributit të tyre nuk është e pasqyruar në vendimin e njësisë bazë dhe/ose nga vetë autorët në hyrjen e monografisë së botuar.

Neni 9

Promovimi akademik në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimitari të tjera akademike

1. Për efekt të promovimit akademik, për personelin akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarja e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", në:
 - a) komitete shkencore apo redaktuese;
 - b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
 - d) projekte të finançuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - e) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;

RREGULLORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

- ë) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
- f) projektet e transferimit teknologjik të patentave.
2. Për efekt të promovimit akademik, për personelin akademik të cilët vijnë nga IAL-të e tjera, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", në veprimtaritë e mëposhtme:
- a) komitete shkencore apo redaktuese;
 - b) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - c) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - d) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Neni 10

Ekuivalentimi në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari të tjera

1. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatitit i cili është personel akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës, në së paku 4 (katër) veprimtari të përcaktuara në nenin 9, pika 1, mund të ekuivalentohet me:
 - a) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njoitura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).".
 - b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
2. Pavarësisht numrit të lartë të angazhimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit në veprimtari shkencore, nuk mund të bëhet më shumë se 1 (një) ekuivalentim sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1/a/b të këtij neni.
3. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 9, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

RREGULLORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

4. Për personelin akademik nga IAL të tjera, ekuivalentimi sipas germave a dhe b të pikës 1 të këtij neni do të bëhet duke merrë në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, në të 4 (katër) veprimtaritë e përcaktuara në nenin 9, pika 2.

Neni 11

Realizimi i studimit postdoktoratë në një nga vendet anëtare të BE-së

1. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje të paktën 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me:
 - a) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI)." dhe 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 12

Vlefshmëria e botimeve shkencore për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar"

Për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore "Doktor", deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "Profesor i asociuar".

KREU III

STANDARDET PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK "PROFESOR"

Neni 13 **Përvoja akademike**

1. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet:
 - a) të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
 - b) të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 12 (dymbëdhjetë)-vjeçare akademike pas fitimit të gradës shkencore "Doktor".

Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 8 (tetë) vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 12 (dymbëdhjetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përllogaritet me një koeficient prej 1.5 vitesh kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

- c) Si rregull, të ketë udhëhequr ose bashkudhëhequr, të paktën 2 (dy) doktorata. Bashkudhëheqja duhet të jetë me personel akademik të kategorisë "Profesor", me IAL brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe.

Në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, duhet të ketë udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar, ndërsa kriteri për udhëheqjen e doktoratës tjetër konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është angazhuar në mësimdhënie në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të paktën për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pa ndërprerje ose 1 (një) vit me ndërprerje, në tri vitet e fundit.";

- ç) të jetë i aftë të mbajë ligjërata në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frëngje, gjermane, italiane, spanjolle para jurisë në përputhje me statutin, rregulloren e IAL-së dhe nenin 20 të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Botimet e realizuara nga personeli akademik

1. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin "Profesor", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:
 - c) Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njoitura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI)."; Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 4(katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.
 - a) ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 15

Monografia shkencore

1. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 13, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - a) botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore "Profesor i asociuar" brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen

RREGULLORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përbajtje me të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) "Profesorë" të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës, për të cilin duhet të paraqitet evidencë e titullit "Profesor" në vandin përkatës.

- b) Të gjitha procedurat e pikës a, të kryhen/të jenë kryer para procesit të botimit.
- c) monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkontinentale, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njoitura ndërkontinentale, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktori i impaktit IF ose Journal Citation Indicator (JCI).".
- d) monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii) 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkontinentale, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njoitura ndërkontinentale, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te Journal Citation Report (JCR), faktori i impaktit IF ose Journal Citation Indicator (JCI).".
- e) Monografia do t'i njihet, përfundimisht, ekuivalenti sipas përcaktimeve, përkatësisht, të paragrafit b), Pika 5 e Kreut III të VVKM 112, datë 23.02.2018, të ndryshuar, vetëm dy autorëve sipas rasteve të meposhtme:
 - Në rastin kur monografia ka vetëm dy autorë, do t'i njihet të dy autorëve.
 - Në rastin kur monografia ka më tepër se dy autorë, do ti njihet dy autorëve që kanë përqindjen më të madhe të kontributit kur kjo përqindje eshte e pasqyruar në vendimin e njësisë bazë dhe/ose nga vetë autorët në hyrjen e monografisë së botuar.
 - Në rastin kur monografia ka më tepër se dy autorë, do ti njihet vetëm autorit të parë dhe të dytë sipas renditjes në monografi, kur përqindja e kontributit të tyre nuk është e pasqyruar në vendimin e njësisë bazë dhe/ose nga vetë autorët në hyrjen e monografisë së botuar.

Neni 16

**Promovimi akademik në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në
veprimitari akademike**

1. Për efekt të promovimit akademik, për personelin akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asociuar", në:
 - a) komitete shkencore apo redaktuese;
 - b) veprimitari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
 - ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - d) projekte të finançuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.
2. Për efekt të promovimit akademik, për personelin akademik të cilët vijnë nga IAL-të e tjera, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asociuar", në veprimitaritë e mëposhtme:
 - e) komitete shkencore apo redaktuese;
 - f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - g) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Neni 17

**Ekuivalentimi në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimitari
akademike**

1. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit i cili është personel akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës në së paku 4 (katër) veprimitari të përcaktuara në nenin 16, pika 1 mund të ekuivalentohet me:
 - a) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të

RREGULLORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit te *Journal Citation Report (JCR)*, faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator (JCI)*;";

- b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtarë (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
2. Pavarësisht numrit të lartë të angazhimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit në veprimtari shkencore, nuk mund të bëhet më shumë se 1 (një) ekuivalentim sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1/a/b të këtij neni.
3. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 16, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.
4. Për personelin akademik nga IAL të tjera, ekuivalentimi sipas germave a dhe b të pikës 1 të këtij neni do të bëhet duke merrë në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarjen e kandidatit, në të 4 (katër) veprimtaritë e përcaktuara në nenin 16, pika 2.

Neni 18

Vlefshmëria e botimeve shkencore për fitimin e titullit akademik "Profesor"

Për fitimin e titullit akademik "Profesor", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik "Profesor i asociuar" deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "Profesor".

KREU IV

PROCEDURAT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

Neni 19

Paraqitja e kërkesës dhe dosjes për aplikim

1. Kandidati paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore. Dokumentacioni që përmban dosja duhet të dorëzohet nga kandidati në hard-copy si dhe në format elektronik. Drejtuesi i njësisë kryesore i'a përcjell përvlerësim njësisë bazë brenda 20 (njëzet) ditëve.
2. Pas vlerësimit nga njësia bazë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, dosja e kandidatit përmes drejtuesit të njësisë kryesore përkatëse i përcillet Senatit Akademik, i cili përmes kryetarit të tij, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marja e dosjes, ia përcjell Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
3. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ, dosja i kthehet drejtuesit të njësisë kryesore me argumentet dhe sugjerimet përkatëse.
4. Kandidati ka të drejtë të aplikojë sérish, brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh.
5. Vendimi i njësisë bazë merret nga shumica e anëtarëve të saj."
6. Kur kandidati nuk është personel akademik i UPT-së, ai plotëson dosjen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me Rregulloren e fitimit të titujve akademikë në UPT.
7. Dosja i paraqitet Rektorit të UPT-së ne rrugë institucionale, i cili i'a përcjell atë KPPA.
8. KPPA pasi shqyrtan fushën akademike të kandidatit si dhe elementët përbërës të dosjes së tij në përputhje me Rregulloren e fitimit të titujve akademikë në UPT, i'a përcjell dosjen drejtuesit të njësisë kryesore të UPT-së, që mbulon fushën akademike në fjalë.
9. Më pas, procedura vijnë në mënyrë të njëjtë si për kandidatët e UPT-së dhe departamenti i ngarkuar nga drejtuesi i njësisë kryesore respektive përvlerësimin e dosjes

Neni 20

Ngritja e jurisë për vlerësimin e dosjes

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përcjelljes së dosjes nga Senati, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati përban ose jo dokumentacionin përkatës, duke caktuar për këtë qëllim një relator nga KPPA, i cili, si rregull, është anëtar i njësisë kryesore ku ka dorëzuar dosjen kandidati që kërkon titullin akademik.
2. Në rast se dosja konsiderohet e plotë, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik vijon menjëherë, në të njejtën mbledhje, me ngritjen e jurisë për vlerësimin e dosjes.
3. Në rast të evidentimit të mangësive në dosjen e kandidatit, atij i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen, dosja i kthehet kandidatit.
4. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me titullin akademik "Profesor" të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, të paktën, 2 (dy) duhet të janë të ftuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja ose personalitetë të spikatur të fushës.
5. Anëtarët e jurisë propozohen në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik nga drejtuesi i njësisë kryesore me miratimin e rektorit, brenda 10 (dhjetë) ditëve, bashkë me dosjen e kandidatit të miratuar në njësinë bazë.
6. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë). 5 (pesë) kandidatë kërkohet të janë nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore të së njëjtës fushë, ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit dhe/ose i njësive të tjera kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës që mbulojnë fusha të përafërtë me njësinë kryesore. 3 (tre) kandidatë kërkohet të janë nga personel akademik i institucioneve të tjera të arsimit të lartë, të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit.
7. Të paktën, 2 (dy) anëtarë të jurisë duhet të janë të së njëjtës fushë me atë të kandidatit, ndërsa 3 (tre) nga fusha të ngjashme me atë të kandidatit.

Neni 21
Procedura e vlerësimit

1. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së jurisë.
2. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit, juria përgatit raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademiko-didaktike e shkencore të kandidatit, në përfundim të të cilit jepet edhe rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik. Raporti i vlerësimit i përcillet Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
3. Në rastin kur anëtari i jurisë nuk ka të njëjtin vlerësim me pjesën tjetër të saj, ai harton një raport të veçantë, i cili i bashkëngjitet raportit të pjesës tjetër të jurisë.
4. Raporti miratohet me shumicën e anëtarëve të jurisë.
5. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik merr vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas marjes së raportit të vlerësimit nga juria.

Neni 22
Përsëritja e kërkesës për fitimin e titujve akademikë

Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejtë të ripërsërisë kërkesën, pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme, pranë drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 23
Regjistrimi i titullit akademik

1. Titulli akademik regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë dhe në regjistrin e gradave shkencore dhe titujve akademikë të Universitetit Politeknik të Tiranës.
2. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe nënshkruhet nga rektori, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dhënies së vendimit përfundimtar nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.
3. Titulli akademik, për të gjithë kandidatët që vijnë nga IAL e tjera, lëshohet nga institucioni dhe nënshkruhet nga rektori, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e

RREGULLORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

dhënes së vendimit përfundimtar nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik me shënimin " me propozim te IAL qe percjell dosjen.

Neni 24

Revokimi i titujve akademikë

Rektori merr vendimin për revokimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", në rastet kur vërtetohet plagjiatura ose manipulimi i të dhënave në punimet e kandidatit.

KREU V

TITUJ PËR KONTRIBUT TË VEÇANTË

Neni 25

Titulli “Doctor Honoris Causa”

1. Universiteti Politeknik i Tiranës mund të akordojë titullin “Doctor Honoris Causa” për figura të shquara të shkencës e shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit e të shkencës, si dhe në zhvillimin e vendit tonë në tërësi.
2. Ky titull jepet me vendim të Senatit Akademik, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.
3. Numri i titujve “Doctor Honoris Causa” nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) në vit.

~~AKORDIMI I TITULLIT “PROFESOR EMERITUS”~~

Neni 26

Kriteret e titullit “Profesor emeritus”

1. Personelit akademik që mban titullin “Profesor”, pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik të UPT-së i akordohet titulli “Profesor emeritus”, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.
2. Titulli “Profesor emeritus” iu jepet profesorëve në pension, të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në drejtim të veprimtarisë akademike, duke përfshirë dhe arritjet e dedikuara në fushën përkatëse të kërkimit shkencor.
3. Titulli i nderit “Profesor emeritus” i jepet personelit akademik, që plotëson kriterin e përgjithshëm të mbajtjes së titullit “Profesor” të paktën 5vjet.
4. “Profesori emeritus” nuk mund të jenë punonjës efektivë të Universitetit. Nëse “Profesori emeritus”, për arsyet apo nevoja të ndryshme të Universitetit,

RREGULLORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

mbahet ose kthehet në punë, atëherë ai trajtohet finansiarisht si personel akademik "Profesor".

5. Nëse një "Profesor emeritus" merret në punë me pagesë si personel akademik në një institucion tjetër, njësia kryesore "mëmë" mund ta konsiderojë dhe t'i njoftë atij një titull tjetër (p.sh. titullin "Profesor i nderi" ose "Profesor vizitues").

Neni 27

Procedura e aprovimit të titullit "Profesor emeritus"

1. Njësia bazë me pëlgimin e kandidatit, rekomandon dhënien e titullit "Profesor emeritus", bazuar në veprimtarinë akademiko-shkencore dhe në kriteret e lartpërmendura.
2. Nëse njësia bazë vendos të bëjë rekomandimin, ky do të bëhet me shkrim te drejtuesi njësisë kryesore, duke bashkëngjitur një kopje të Curriculum vitae si dhe veprimitari të tjera si më poshtë:
 - a) pëlgimin e profesorit në formë deklarate;
 - b) relacion mbi performancën e mësimdhënies dhe punën e tij krijuar nga njësia bazë, ku ai ka ushtruuar veprimitarinë si personel akademik;
 - c) relacione mbi rezultatet e punës mësimore dhe kërkimore, dëshmi kualifikimesh, brenda dhe jashtë shtetit, bursa kualifikimesh e bashkëpunimesh me institucione të huaja, realizime projektesh të përbashkëta, certifikata referimesh dhe pjesëmarrjesh në konferanca dhe veprimitari të tjera;
 - d) rekomandime nga institucione homologe, dikastere, qendra studimore dhe eksperimentale, nga agrobiznesi, borde pedagogjike dhe studentore.
3. Dekanati i njësisë kryesore shqyrton rekomandimin e njësisë bazë, bashkë me dokumentat e lartpërmendor dhe përcjell me shkresë te Rektori, rekomandimin për titullin duke dhënë edhe opinionin e tij.
4. Rektori gjykon veprimitarinë e profesorit dhe përputhshmérinë ligjore të dosjes dhe ia përcjell rekomandimin për miratimin e titullit Senatit Akademik.
5. Senati Akademik do të vendosë me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë, nëse do të miratojë rekomandimin dhe do të marrë vendimin për dhënien e titullit akademik "Profesor emeritus".
6. Vendimi i Senatit firmoset nga Kryetari i Senatit dhe i përcillet Drejtorisë së Kërkimit Shkencor për regjistrim në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë si dhe në regjistrin e UPT-së.

RREGULLORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

7. Pas regjistrimit, Drejtoria e Kërkimit Shkencor, përgatit formatin, të cilin e firmos Kryetari i Senatit dhe, në një ceremoni, drejtuesi i njësisë kryesore dhe/ose Rektori i dorëzojnë Profesorit titullin "Profesor emeritus".

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 28

Përfundimi i procedurave të filluara për marrjen e titujve akademikë

Për personelin akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon deri në fillimin e vitit akademik 2026-2027, për titullin akademik "Profesor", kriteri i shkronjës "c", të pikës 1, të Nenit 13 të kreut III, konsiderohet i plotësuar nëse ka udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë, të përfunduar.

Ndërsa, në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, kriteri i shkronjës "c", të pikës 1, të Nenit 13, të kreut III, konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është duke udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë dhe duhet të përbushë edhe një nga kushtet e mëposhtme:

- i. Të ketë pasur ose ka rolin e drejtuesit në një projekt ndërkombëtar;
- ii. Të ketë dhënë ose jep mësim në një program në gjuhë të huaj në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht apo italisht, për së paku 6 (gjashtë) muaj;
- iii. Të ketë përfunduar me sukses së paku të gjitha detyrimet e vitit të dytë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të programit të studimit, të doktoratës, të kandidatit doktorant që ka në udhëheqje/bashkudhëheqje të doktoratës.".

Neni 29

Miratimi dhe hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet me vendim të Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

DOKUMENTACIONI PËR KËRKIMN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR”

(Përbajtja e Dosjes)

1. Kërkesa për fillimin e procedurës për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar” drejtuar Njësisë Kryesore.
2. Kërkesa për titullin “Profesor i Asociuar” drejtuar Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
3. Dokumentat përcjellëse të Njësisë Kryesore dhe Senatit Akademik.
4. Vlerësimi nga Njësia Bazë.
5. Skeda Informativë.
6. Curriculum Vitae.
7. Bibliografi e punimeve.
8. Fotokopje e diplomës “Doktor” e noterizuar.
9. Çertifikata të njohjes së gjuhëve të huaja të noterizuara.
10. Fotokopje të referimeve të botuara në “Proceedings” në konferanca e kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”; fotokopje të faqes së parë të “Proceedings” (revistës) ku janë botuar referimet.
11. Fotokopje të artikujve të botuar në periodikë shkencorë brenda dhe jashtë vendit pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”; fotokopje të faqes së parë të revistës ku janë botuar artikujt.
12. Kopje të monografive.
13. Dokumentacion që vërteton pjesmarrjet dhe angazhimet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
14. Dokumentacion për vjetërsinë në mësimdhënie (gjithsej dhe pas gradës “Doktor”).
15. Dokumentacion lidhur me lëndët ose modulet e zhvilluara.
16. Dokumentacion lidhur me studime postdoktorale.
17. Dokumentacion tjetër plotësues mbështetës.

DOKUMENTACIONI PËR KËRKIMN E TITULLIT “PROFESOR”

(Përbajtja e Dosjes)

1. Kërkesa për fillimin e procedurës për fitimin e titullit “Profesor” drejtuar Njësisë Kryesore.
2. Kërkesa për titullin “Profesor” drejtuar Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
3. Dokumentat përcjellëse të Njësisë Kryesore dhe Senatit Akademik.
4. Vlerësimi nga Njësia Bazë.
5. Skeda Informative.
6. Curriculum Vitae.
7. Bibliografi e punimeve.
8. Fotokopje të noterizuara të Diplomës së Doktoratës dhe të vërtetimit të dhënies së titullit Prof. Asoc.
9. Çertifikata të njohjes së gjuhëve të huaja të noterizuara.
10. Fotokopje të referimeve të botuara në “Proceedings” në konferanca e kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare pas titullit Prof. Asoc.; fotokopje të faqes së parë të “Proceedings” (revistës) ku janë botuar referimet.
11. Fotokopje të artikujve të botuar ose pranuar për botim në periodikë shkencorë brenda dhe jashtë vendit pas fitimit të titullit Prof. Asoc.; fotokopje të faqes së parë të revistës ku janë botuar artikujt.
12. Fotokopje të faqeve të para të doktoratave të udhëhequra.
13. Fotokopje të faqes së parë dhe të dytë të teksteve universitare.
14. Kopje të monografive.
15. Dokumentacion që vërteton pjesmarrjet dhe angazhimet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
16. Dokumentacion për vjetërsinë në mësimdhënie (gjithsej dhe pas fitimit të gradës “Doktor”).
17. Dokumentacion lidhur me lëndët ose modulet e zhvilluara.
18. Dokumentacion tjetër plotësues mbështetës.



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

KOMISIONI PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914; www.upt.edu.al

SKEDA PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR”

I. Të dhëna për kandidatin

Emri, atësia, mbiemri Universiteti		Grada <i>Doktor</i> (Data, Nr. i vendimit)	Datë xx.xx.xxxx Vendim Nr. xxx
Fakulteti		Vjetërsia në mësimdhënie	
Departamenti		Vjetërsia në punë	

II. Skeda e veprimtarisë

NR	VEPRIMTARIA	KRITERI	REALIZIMI
1	Përvoja në mësimdhënie, (pas grades Doktor), në vite pune, për lektorët me kohë të plotë, (e dokumentuar).	5	
2	Përvoja në mësimdhënie (pas gradës Doktor), në vite pune, për lektorët me kohë të pjesshme, (e dokumentuar).	8	
3	Referime/postera, si autor i parë, në konferenca dhe kongrese shkencore (pas gradës Doktor).	5	
4	Referime/postera, si autor i parë, mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN, (pas gradës Doktor).	2	
5	Artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara (pas gradës Doktor).	5	
6	Artikuj shkencorë, të botuar si autor i parë ose i dytë në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI) (pas gradës Doktor).	2	
7	Artikuj shkencorë, si autor i parë, (pas gradës Doktor).	2	
8	Monografi shkencore, botuar në gjuhë të huaj jashtë vendit (kur plotëson kushtet e përcaktuara në VKM 112, datë 23.02.2018 të ndryshuar me VKM 128, datë 6.03.2024).		
9	Monografi shkencore, botuar brenda vendit (kur plotëson kushtet e përcaktuara në VKM 112, datë 23.02.2018 të ndryshuar me VKM 128, datë 6.03.2024).).		
10	Cikle të plota leksionesh për 3 (tre) vite akademike.	1	
11	Angazhime dhe pjesëmarrje në veprimtaritë e përcaktuara në Pikën 7, Kreu II, VKM 112, datë 23.02.2018 të ndryshuar me VKM 128, datë 6.03.2024). (pas gradës Doktor).		
12	Studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe.		

III. Veprimtari të tjera të realizuara nga kandidati

(Veprimtari të ndryshme mbështetëse ndaj institucionit, poste drejtuese brenda institucionit ose në institucionë të tjera të arsimit të lartë, studime dhe projekte, pjesëmarrje në shoqata profesioniste etj...)

Kërkuesi

Tiranë, më



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

KOMISIONI PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 4, Tiranë, Tel/Fax: + 355 4 2227914; www.upt.edu.al

SKEDA PËR FITIMIN E TITULLIT "PROFESOR"

I. Të dhëna për kandidatin

Emri, atësia, mbiemri Universiteti		Titulli <i>Prof. Asoc.</i> (Data, Nr. i vendimit)	Datë xx.xx.xxxx Vendim Nr. xxx
Fakulteti		Vjetërsia në mësimdhënie	
Departamenti		Vjetërsia në punë	

II. Skeda e veprimtarisë

NR	VEPRIMTARIA	KRITERI	REALIZIMI
1	Përvoja në mësimdhënie, (pas gradës Doktor), në vite pune, për personelin akademik me kohë të plotë, (e dokumentuar).	8	
2	Përvoja në mësimdhënie, (pas titullit Prof. Asoc.), në vite pune, (e dokumentuar).	5	
3	Përvoja në mësimdhënie, (pas gradës Doktor), në vite pune, për personelin akademik me kohë të pjesshme, (e dokumentuar).	12	
5	Udhëheqje/Bashkudhëheqje Doktoratash të përfunduara.	2	
6	Udhëheqje/Bashkudhëheqje Doktoratash të përfunduara (kur veprimtaria akademike-shkencore është kryer pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë).	2	
7	Ne rast se realizimi në pikën 6 është 1 (një), angazhim në mësimdhënie në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-s, të paktën për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pa ndërprerje ose 1 (një) vit me ndërprerje, në tri vitet e fundit (kur veprimtaria akademike-shkencore është kryer pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë).		
8	Udhëheqje/Bashkudhëheqje Doktoratash të përfunduara për personelin akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon deri në fillimin e vitit akademik 2026-2027.	1	
9	Udhëheqje/Bashkudhëheqje Doktoratash në proces për personelin akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon deri në fillimin e vitit akademik 2026-2027 (kur veprimtaria akademike-shkencore është kryer pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë) dhe duhet të përbushë edhe një nga kushtet e mëposhtme: a) Të ketë pasur ose ka rolin e drejtuesit në një projekt ndërkombëtar; b) Të ketë dhënë ose jep mësim në një program në gjuhë të huaj në një nga pesë gjuhjet e Bashkimit Evropian, anglisht, spanjisht apo italisht; frëngjisht, gjermanisht, c) Të ketë përfunduar me sukses së paku të gjitha detyrimet e vitit të dytë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të programit të studimit, të doktoratës, të kandidatit doktorant që ka në udhëheqje/bashkudhëheqje të doktoratës.	1	
10	Referime/postera, si autor i parë, në konferanca dhe kongrese shkencore (pas titullit Prof. Asoc.).	5	

11	Referime/postera, si autor i parë, mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombe (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN (pas titullit Prof. Asoc).	2	
12	Artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombe të indeksuara (pas titullit Prof. Asoc).	7	
13	Artikuj shkencorë, të botuar si autir i parë ose i dytë në revista ndërkombe të indeksuara në një nga databazat e të dhënavë të revistave shkencore të njohura ndërkombe, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi te Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI) (pas titullit Prof. Asoc).	3	
14	Artikuj shkencorë, si autor i parë, (pas titullit Prof. Asoc).	4	
15	Monografi shkencore, botuar në gjuhë të huaj jashtë vendit (kur plotëson kushtet e përcaktuara në VKM 112, datë 23.02.2018 të ndryshuar me VKM 128, datë 6.03.2024).		-
16	Monografi shkencore, botuar brenda vendit (kur plotëson kushtet e përcaktuara në VKM 112, datë 23.02.2018 të ndryshuar me VKM 128, datë 6.03.2024).		-
17	Titullar lënde ose moduli, për jo më pak se 5 vite akademike.		
18	Angazhime dhe pjesëmarrje në veprimtaritë e përcaktuara në Pikën 6, Kreu III, VKM 112, datë 23.02.2018 të ndryshuar me VKM 128, datë 6.03.2024. (pas titullit Prof. Asoc).		

III. Veprimtari të tjera të realizuara nga kandidati

(Veprimtari të ndryshme mbështetëse ndaj institucionit, poste drejtuese brenda institucionit ose në institucionë të tjera të arsimit të lartë, studime dhe projekte, pjesëmarrje në shoqata profesioniste etj...)

Kërkuesi

Tiranë, më

BIBLIOGRAFI E PUNIMEVE

Grada\Titulli _____(emri, mbiemri)

Gradën shkencore “**Doktor**” Z/Znj. xxxxxxxx e ka marrë në datën xxxxxxxxxxxx
Eksperiencia në mësimdhënie: **xxxxx vjet**.

I. TEKSTE

II. ARTIKUJ SHKENCORË

- Autor i parë ose i dytë në artikujt shkencorë të botuar në revista me faktor impakti;
- Autor i parë në artikujt shkencorë në revista të indeksuara;
- Autor i dytë, i tretë, etj., në artikujt shkencorë në revista të indeksuara.

III. REFERIME NË KONFERENCA

- Referimet si Autor i parë në veprimtari shkencore kombëtare/ ndërkontinentale (simpozium, konferencë, kongres);
- Referimet si Autor i dytë, i tretë, etj., në veprimtari shkencore kombëtare/ ndërkontinentale (simpozium, konferencë, kongres).

IV. BOTIME TË KONFERENCAVE NDËRKOMBËTARE NË PROCEEDINGS

- **Referimet si Autor i parë** në veprimtari shkencore ndërkontinentale (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës të botuara në Proceedings të indeksuar, me kod ISBN ose ISSN.
- **Referimet si Autor i dytë, i tretë etj.**, në veprimtari shkencore kombëtare/ ndërkontinentale (simpozium, konferencë, kongres) të botuara në Proceedings me kod ISBN ose ISSN.

V. MONOGRAFI

VI. TITULLAR LËNDE/MODULI

VII. VEPRIMTARI MBËSHTETËSE INSTITUCIONALE (PIKA 7, Kreu II, VKM 112; NENI 9, KREU II I RREGULLORES SË FITIMIT TË TITUJVE AKADEMIKE NË UPT)

Merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor".

VIII. UDHEHEQJE DOKTORATASH

IX. VEPRIMTARI DHE KONTRIBUTE TË TJERA

X. Etj.

KERKUESI

BIBLIOGRAFI E PUNIMEVE

Grada\Titulli _____(emri, mbiemri)

Gradën shkencore "**Doktor**" Z/Znj. xxxxxxxx e ka marrë në datën xxxxxxxxx.
Titullin Akademik "**Profesor i Asociuar**" Z/Znj. xxxxxxxx e ka marrë në datën
xxxxxxxx.

Eksperiencia në mësimdhënie: **xxxxx vjet.**

I. TEKSTE

II. ARTIKUJ SHKENCORË

- Autor i parë ose i dytë në artikujt shkencorë të botuar në revista me faktor impakti;
- Autor i parë në artikujt shkencorë në revista të indeksuara;
- Autor i dytë, i tretë, etj., në artikujt shkencorë në revista të indeksuara.

III. REFERIME NË KONFERENCA

- Referimet si Autor i parë në veprimtari shkencore kombëtare/ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres);
- Referimet si Autor i dytë, i tretë, etj., në veprimtari shkencore kombëtare/ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres).

IV. BOTIME TË KONFERENCAVE NDËRKOMBËTARE NË PROCEEDINGS

- **Referimet si Autor i parë** në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës të botuara në Proceedings të indeksuar, me kod ISBN ose ISSN.
- **Referimet si Autor i dytë, i tretë, etj.**, në veprimtari shkencore kombëtare/ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të botuara në Proceedings me kod ISBN ose ISSN.

V. MONOGRAFI

VI. TITULLAR LENDE/MODULI

VII. VEPRIMTARI MBËSHTETËSE INSTITUCIONALE (Pika 6, Kreu III, VKM 112, NENI 16, KREU III I RREGULLORES SË FITIMIT TË TITUJVE AKADEMIKE NË UPT)

Merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarria e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik "Profesor i Asociuar".

VIII. UDHËHEQJE DOKTORATASH

IX. VEPRIMTARI DHE KONTRIBUTE TË TJERA

X. Etj.

KERKUESI

**Raporti për promovimi akademik në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në
veprimitari të tjera akademike për Dr. /Prof. Asoc. (Emri, Mbiemri)**

- I. Për efekt të promovimit akademik, për personelin akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, të merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor"/ titullit akademik "Profesor i asocuar", në:
- a) Komitete shkencore apo redaktuese;
 - 1.
 - b) Veprimitari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - 1.
 - c) Projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
 - 1.
 - ç) Përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - 1.
 - d) Projekte të finançuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime përinjësive për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - 1.
 - e) Vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - 1.
 - ë) Si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - 1.
 - f) Projektet e transferimit teknologjik të patentave.
 - 1.

- II. Për efekt të promovimit akademik, për personelin akademik të cilët vijnë nga IAL-të e tjera, të merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor"/ titullit akademik "Profesor i asocuar", në:
- a) Komitete shkencore apo redaktuese;
 - 1.
 - b) Vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - 1.
 - c) Si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - 1.
 - d) Projektet e transferimit teknologjik të patentave.
-

I gjithë raporti i angazhimit është i shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm që vërteton pjesëmarrjen e Dr./ Prof. Asoc. (Emri, Mbiemri) në këto veprimtari.

Mbështetur sa më sipër, Dr./Prof. Asoc. (Emri, Mbiemri) është angazhuar dhe ka marrë pjesë në X (___) veprimtari, dhe kjo mund të ekuivalentohet me:

Drejtuesi i Njësisë Bazë

Titulli, Emër Mbiemër

*VKM Nr. 112, datë 23.02.2018, i ndryshuar, Kreu II, pika 9, "Niveli sasior i treguesve, të përcaktuar në pikën 7 të këtij kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosën në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të këtij kreu, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik".